



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 6, Datë 23.03.2015

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR PROJEKTIN “NDËRTIMI I
HIDROCENTRALEVE “QARR” DHE “KALTANJ” NË PELLGUN UJËMBLEDHËS
TË LUMIT OSUM”, KOMUNA ÇLIRIM, QARKU KORÇË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, Vendimit nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për Projektin “Ndërtimi i Hidrocentraleve “Qarr” dhe “Kaltanj” në pellgun ujëmbledhës të lumit Osum”, komuna Çlirim, Qarku Korçë, me subjekt kërkues shoqërinë konçensionare “Qarr&Kaltanj” sh.p.k.
2. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
 - a. Dokumenti i Rregullores së Lejes së Ndërtimit;
 - b. Harta e Planvendosjes së Strukturave.
3. Formulari i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njësisë së Qeverisjes Vendore.
4. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



Z. DAMIAN GJIKNURI

MINISTËR I ENERGISË DHE INDUSTRIË



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT